



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

KF.nr.65/22

GJYKATA KOMERCIALE, Dhomat e shkallës së parë, Departamenti Fiskal, me gjyqtarin Fisnik Nuli, dhe me bashkëpunëtorin profesional Visar Gashi, në konfliktin administrativ, të paditësit “E...” Sh.P.K. me seli në Pejë, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Shoqëria e Avokatëve “...” në Prishtinë, kundër të paditurit Dogana e Kosovës në Prishtinë, me bazë juridike - anulim vendimi, objekt kontesti – Përpunim i Brendshëm, vlerë kontesti e pa përcaktuar, në seancën e shqyrtimit gjyqësor kryesor publik të mbajtur, me datë 26.09.2022, në prani të përfaqësuesit të autorizuar të paditësit G.B dhe të përfaqësuesit të autorizuar të palës së paditur M.K, mori këtë:

A K T G J Y K I M

- I. APROVOHET kërkesëpadia e paditësit “E...” Sh.P.K. me seli në Pejë, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Shoqëria e Avokatëve “...” në Prishtinë, si e bazuar.
- II. ANULOHET vendimi nr. 01.3.2.2/16899 i datës 17.01.2020 i Doganës së Kosovës dhe lënda KTHEHET NË RISHQYRTIM DHE RIVENDOSJE.
- III. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale

A R S Y E T I M

Paditësi “E...” Sh.P.K. me seli në Pejë, me padinë e paraqitur në Gjykatë me datë 25.02.2020, të plotësuar me parashtrësën e datës 12.10.2020, ka iniciuar konfliktin administrativ kundër të paditurës Dogana e Kosovës në Prishtinë, me të cilën i ka propozuar gjykatës të aprovohet kërkesëpadia si e bazuar, të anulohet aktvendimi kontestues dhe lënda të kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje tek e paditura. Në seancën e shqyrtimit kryesor dhe në fjalën përfundimtare përfaqësuesi i autorizuar i paditësit deklaroi se Konsiderojmë se vendimi i të paditurës është jo i drejtë dhe jo i bazuar ligjërisht. E paditura pa pasur një argumentim ligjor i’ka refuzuar paditësit kërkesën për tu pajisur me autorizim për përpunim të brendshëm për PMNE, me pretendimin se së pari paditësi duhet të pajiset me licencë nga MTI, ndërkohë që nga MTI-ja bazuar në komunikimet zyrtare, respektivisht nga përgjigjet e marra nga ky institucion nuk kërkohet ndonjë licencë e veçantë për eksportimin e produktit. Për më tepër mbetemi

pranë pretendimeve si të cekura në plotësimin e padisë me parashtrirat e datës 12.10.2020 dhe 11.01.2022, dhe duke pasur parasysh nga sa u tha më lartë, kërkojmë nga gjykata që të aprovohet padia si e bazuar, dhe të anulohet vendimi i kontestuar, dhe çështja të kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje pranë të paditurës. Shpenzimet e procedurës nuk i kërkon.

E paditura, në përgjigje në padinë të datës 31.03.2021 e konteston në tërësi si të pa bazuar kërkesëpadinë e paditësit. Aktvendimi i atakuar është marr komfor të të gjitha dispozitave në fuqi dhe ajo në të cilën pretendon pala se ky vendim është marrë me shkelje ligjore nuk qëndron fare, me arsyetimin se vendimi i kontestuar është marrë konform legjislacionit në fuqi dhe në mënyrë të drejtë ndërsa pala paditëse pretendimet e veta nuk i ka vërtetuar as edhe me një provë të vetme. Përfaqësuesi i autorizuar i paditësit në seancën e shqyrtimit kryesor dhe në fjalën përfundimtare deklaroi se : konsiderojmë se në rastin konkret Dogana e Kosovës, përkatësisht Sektori i Procedurave dhe Autorizimeve, duke vepruar me kompetencë profesionale dhe ligjore, që nga parashtrimi i kërkesës së këtu paditësit për autorizim ka trajtuar me seriozitet dhe profesionalizëm të gjitha kërkesat e palës, duke e njoftuar në lidhje me obligimet që i ka për plotësim të lëndës pas parashtrimit të kërkesës për autorizim, dhe duke i dhënë disa herë afate shtesë për sjelljen e provave të kërkuara, për të cilat pala-këtu paditësi ka dështuar që ti plotësoj, e të cilat kërkesa për plotësim të lëndës me prova përkatëse janë të renditura në arsyetimin e aktvendimit 04.1.5/11347 të datës 22.10.2019. Gjithashtu, të njëjtat arsyetime janë dhënë edhe pas ankesës së palës në aktvendimin kontestues 01.3.2.2/16899 të datës 17.01.2020. Konsiderojmë se pala nuk ka plotësuar, apo ka dështuar të plotësoj kërkesat e nevojshme për tu pajisur me autorizim për procedurë të përpunimit të brendshëm të derivateve për prodhim dhe eksport. Shpenzimet e procedurës nuk i kërkon.

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, Gjykata në procedurën e provave të shqyrtimit gjyqësor kryesor-publik, ka administruar provat dhe atë: Aktvendimi 01.3.2.2/16899 të datës 17.01.2020, Kërkesa e ushtruar në MTI nr.8104/27.09.2019, E-mailat të datës 01.10.2019, 04.10.2019, 07.10.2019, 09.10.2019, 25.10.2019, 22.10.2019, 04.11.2019, 13.01.2020, 16.01.2020, 21.01.2020, 29.01.2020, 02.04.2020, 10.01.2020, 09.01.2020, 11.10.2019, 07.10.2019, 14.10.2019, 27.09.2019, 23.09.2019, 27.08.2019, 01.12.2019, 03.08.2020, 28.07.2020, 19.07.2020, 15.01.2021, Shënimi Sqarim për Doganën e Kosovës nr.16899 i datës 16.01.2020, dhe

i pa nënshkruar, Kërkesa për Kthim të Taksës së Akcizës për Doganën e Kosovës pa numër dhe datë, DUD-at nr. ..., nr., ankesa për Doganën e Kosovës e datës 30.11.2019, si dhe Plotësimi nr.16899/13.12.2019, CMR nr.181270, Fatura nr. ..., Përgjigja në Padi e datës 31.03.2021, të Dhënat nga ARBK lidhur me këtu paditësin, aktvendimi 11347/22.10.2019, përshkrimi i Procesit Teknologjik për Fitimin e Produktit Komercial i datës 10.12.2019, deklarata Doganore IMA e datës 08.11.2019, e datës 30.11.2019, Packing List e datës 24.12.2019, Kapitulli 34 i TARIK, Licenca nga MTI nr. ... për periudhën 01.07.2019 deri 30.06.2021.

Gjykata vlerësoi ligjshmërinë e vendimit kontestues, thëniet në padi dhe seancë, përgjigje në padi, shkresave të lëndës në këtë konflikt administrativ, bëri ballafaqimin e provave që kanë ofruar të dy palët, dhe bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjithave së bashku, mbështetur edhe në dispozitat nga neni 8, të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK-së), dhe arriti në përfundimin se në këtë konflikt administrativ, duhet vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, për këto arsye:

Nga provat e administruara në këtë konflikt administrativ, nga Aktvendimi 11347/22.10.2019, i Doganës së Kosovës, deklarimeve në padi, shkresat e lëndës, aktvendimi kontestues, dhe deklarimeve në seancën e shqyrtimit kryesor, Gjykata ka gjetur se nuk është kontestues fakti se paditësi ka paraqitur kërkesë për pajisje me autorizim të procedurës së përpunimit të brendshëm pranë Sektorit të Procedurave dhe Autorizimeve në Doganën e Kosovës, me ç' rast e njëjta kërkesë nga e paditura është refuzuar me aktvendimin si më lartë. Jo kontestuese mbesin edhe faktet se paditësi, ka ushtruar ankesë pranë Doganës së Kosovës, e për të cilën ankesë, Dogana e Kosovës me datë 17.01.2020, ka sjell Aktvendimin nr. 01.3.2.2/16899 si akt administrativ përfundimtar i nxjerrë në procedurën administrative në shkallë të dytë, me të cilin është refuzuar kërkesat e subjekti në procedurë, e kundër të cilit, paditësi me padinë e datës 25.02.2020, të plotësuar me parashtresën e datës 12.10.2020, ka iniciuar konfliktin administrativ pranë kësaj gjykate.

Nga ekzaminimi i vendimit kontestues, Gjykata konstaton se e paditura Dogana e Kosovës në shkallë të dytë e ka refuzuar kërkesën e subjektit në procedurë këtu paditësit, për pajisje me autorizim të procedurës së përpunimit të brendshëm. E paditura ka vlerësuar se Sektori i Procedurave dhe Autorizimeve ka konsideruar se dokumentacioni i prezantuar dhe i bashkangjitur në lëndë në procedurë administrative

nuk është i mjaftueshëm për trajtimin e kërkesës, tutje këtu e paditura edhe pas pasi ka kërkuar plotësimin e lëndës këtu paditësi ka dështuar të prezantoj procesin teknologjik të hartuar nga ekspert të certifikuar, specifikacionin e pajisjeve teknologjike që përkrahin procesin, licencën për prodhim të lëshuar nga MTI-ja, konform ligjit nr. 03/L-138, dhe dëshmi relevantë që produkti final tariforet në kreun 3403.

Gjykata nga aktvendimi kontestues vëren se ai përmban të meta të cilat e pengojnë vlerësimin e ligjshmërisë së vendimit të kontestuar, te metat e tilla konsistojnë në faktin se arsyetimi i vendimit kontestuese përmban të dhëna te pamjaftueshme dhe jo të plota sa i përket refuzimit të kërkesës për pajisje me autorizim të procedurës së përpunimit të brendshëm. Në arsyetimin kontestues nuk është dhënë arsyetim i bazuar, përse është kërkuar licenca nga MTI-ja, kur paditësi ka prezantuar komunikime zyrtare me MTI-në që dëshmon se në rastin konkret nuk kërkohet ndonjë licencë e veçantë për eksportimin e produktit të këtu paditësit për tu pajisur me autorizim të procedurës së përpunimit të brendshëm nga e paditura.

Mos vërtetimi i plotë i gjendjes faktike, Gjykata e konsideron faktin se vendimi i kontestuar nuk përmban arsye për faktet vendimtare të vlefshme për gjykimin e drejtë të kësaj çështje juridike-administrative. Në arsyetim të vendimit kontestues, thuhet se Sektori i procedurave dhe autorizimeve ka vepruar drejt kur ka refuzuar kërkesën e këtu paditësit për tu pajisur me autorizim përkatës, pasi që këtu paditësi ka dështuar të prezantoj dokumentacionin e nevojshëm për trajtimin e kërkesës për tu pajisur me autorizim të procedurës së përpunimit të brendshëm, mirëpo një konstatim i tillë për Gjykatën është tërësisht i pa qëndrueshëm dhe i pa mbështetur në KDAK-ë 03/L-109, dhe UA 11/2009, është shumë kontradiktor në vetvete dhe në raport me dokumentacionin e prezantuar, si dhe me bazën ligjore në fuqi, përderisa paditësi në këtë konflikt administrativ ka paraqitur prova dhe atë kërkesën e ushtruar në MTI nr.8104/27.09.2019, E-mailat të datës 01.10.2019, 04.10.2019, 07.10.2019, 09.10.2019, 25.10.2019, 22.10.2019, 04.11.2019, 13.01.2020, 16.01.2020, 21.01.2020, 29.01.2020, 02.04.2020, 10.01.2020, 09.01.2020, 11.10.2019, 07.10.2019, 14.10.2019, 27.09.2019, 23.09.2019, 27.08.2019, 01.12.2019, 03.08.2020, 28.07.2020, 19.07.2020, 15.01.2021, si dhe Licenca nga MTI nr.7443-00-05-03-4852 për periudhën 01.07.2019 deri 30.06.2021.

Gjykata e obligon të paditurën se në rishqyrtim dhe rivendosje, duhet te konstatoj këto pretendime të cekura si më lartë dhe argumentet e paditësit dhe të deklarohet lidhur me

provat e administruara përkatësisht E-mailat të datës 01.10.2019, 04.10.2019, 07.10.2019, 09.10.2019, 25.10.2019, 22.10.2019, 04.11.2019, 13.01.2020, 16.01.2020, 21.01.2020, 29.01.2020, 02.04.2020, 10.01.2020, 09.01.2020, 11.10.2019, 07.10.2019, 14.10.2019, 27.09.2019, 23.09.2019, 27.08.2019, 01.12.2019, 03.08.2020, 28.07.2020, 19.07.2020, 15.01.2021, si dhe Licenca nga MTI nr.7443-00-05-03-4852 për periudhën 01.07.2019 deri 30.06.2021. Në arsyetimin e vendimit kontestues shihet se e paditura nuk ka shqyrtuar drejtë pretendimet e paditësit kur ka konstatuar mungesë të dokumentacionit për të lëshuar autorizimin përkatës, andaj një akt administrativ i tillë nuk përmban një përmbledhje të konstatimeve faktike bazuar në provat e paraqitura gjate procedimit administrativ ose në faktet e siguruara nga administrata.

Të metat e mësipërme janë të asaj natyre që e bëjnë të pa mundur vlerësimin e ligjshmërisë së vendimit të kontestuar, prandaj aktvendimi i atakuar u deshtë që doemos të anulohet, tutje Gjykata e obligon të paditurën që në ri procedurë të deklarohet edhe lidhur me provat e paraqitura nga paditësi në këtë konflikt administrativ dhe atë përshkrimin e Procesit Teknologjik për Fitimin e Produktit Komercial të datës 10.12.2019, deklaratat Doganore IMA të datës 08.11.2019, dhe 30.11.2019, dhe të administruar nga Gjykata e të cilat u përmenden më lartë.

Me rastin e nxjerrjes së vendimit të ri, e paditura të vlerësoj drejt gjendjen faktike që rezulton nga dokumentacioni i mallit të deklarohet veç e veç lidhur me provat e prezantuara nga këtu paditësi dhe të aplikoj drejt dispozitat ligjore të KDAK-së 03/L-109, nenet 118 deri 132, dhe të UA 11/2009, për zbatimin e KDA-së, nenet 311 deri 325, me të cilën përcaktohet kushtet për lëshimin e autorizimit për procedurën e përpunimit të brendshëm. Vërejtjet e cekura janë të obligueshme për organin e paditur, duke u bazuar në nenin 65, të Ligjit për Konfliktet Administrative.

Gjykata vendos për çështjen e konfliktit administrativ në bazë të fakteve të vërtetuara në procedurë administrative, në vështrim të nenit 43, paragrafi 1, të LKA-se. Në bazë të këtij parimi, Gjykata e ka të pamundur të vendos në mënyrë meritore në këtë konflikt administrativ për arsye se ekzistojnë të meta të cilat e pengojnë vlerësimin e ligjshmërisë së vendimit të kontestuar, andaj e aprovon padinë e paditësit, anulon aktvendimin e kontestuar, dhe lënda kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje.

Vendimi që secila palë t'i bart shpenzimet e veta procedurale është marrë konform nenit 64, të LKA-së.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, Gjykata konform dispozitave ligjore të nenit 43, par 2, e 46, par 1 dhe 2, të LKA-së, ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA KOMERCIALE

Dhomat e shkallës së parë, Departamenti Fiskal

KF.nr.65/22 datë 26.09.2022

Bashkëpunëtori Profesional

Visar GASHI

Gj y q t a r i,

Fisnik NULI

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa, në afat prej 15 ditësh nga marrja e të njëjtit, dhomave të shkallës së dytë, përmes dhomave të shkallës së parë të kësaj gjykate.